

RELACION

MBI

PROJEKTLIGJIN,, PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 35/2023 “ PËR KOMPETENCAT PËR CAKTIMIN E PAGAVE, TRAJTIMEVE TË TJERA FINANCIARE DHE PËRFITIMEVE TË TË PUNËSUARVE NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS PUBLIKE, SI DHE TË PAGËS BAZË MINIMALE NË SHKALLË VENDI”.

Qëllimi i këtij projektligji është rregullimi i vakumit të interpretimit të neni 9, të ligjit nr. 35/2023 “ Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”.

Shkronja “c” e nenit 9 të ligjit në fjalë, ka pasur një pasaktësi në përcaktimin e shpërblimit mujor të këshilltarëve dhe të kryetarëve të fshatrave, e cila në ligjin aktual ka qënë në masën deri në 10 për qind të pagës mujore të kryetarit të këshillit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Nëpërmjet kësaj nisme, duhet të ndryshohet shkronja “c” e nenit 9, duke u saktësuar shpërblimi mujor i këshilltarëve dhe të kryetarëve të fshatrave, në masën deri në 10 për qind të pagës mujore të kryetarit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Arsyeja e këtij propozimi, bëhet për shkak se nuk ka referencë paga e kryetarit të këshillit pasi ai është thjesht anëtar këshilli dhe duke ju referuar ligjit të mëparshëm i cili është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 35/2023 “ Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, ku pagesa e këshilltarëve dhe të kryetarëve të fshatrave ka qënë 10 për qind të pagës mujore të kryetarit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Gjithashtu nëpërmjet dispozitës kalimtare, kam propozuar shtrirjen e efekteve financiare nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2023 “ Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë

vendi”, në kushtet kur nga njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk janë kryer pagesat e mësipërme.

Deputeti porpozues

Antoneta Dhima

A handwritten signature in black ink, appearing to be the name 'Antoneta Dhima' written in a cursive style.